



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetar i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139, për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, pas shqyrtimit, komentimit dhe investimit të paleve, brenda afatit ligjor, me dt. 08.05.2018 e mori këtë:

VENDIM – PRELIMINAR MBI LIGJSHMERIN E SHPRONESIMIT TE PROPOZUAR

1. **APROVOHET** kërkesa e subjektit kërkuar, Komunës së Gjakovës, për interes publik dhe vënien e së drejtës së servitutit, e pjesëve të pronave të paluajtshme në ngastrat kadastrale (pjesëve të tyre) në Z.K.Gjakovë-qytet, për realizimin e infrastrukturës teknike primare të kanalizimit fekal për zonën, për paluajtshmërit të cilat sipas tabelës i bashkëngjiten këtij Vendimi.

2. Pas nënshkrimit të këtij Vendimi brenda 5 (pesë) ditëve të punës, i njëjti Ju dërgohet subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, i njëjti do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

4. Kundër këtij Vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit subjekti kërkuar, cila do person është pronarë ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme i cila është objekt i Vendimit përfundimtar, pavarësisht a është i identifikuar apo jo në tabelën e bashkëngjitur këtij Vendimi.

5. Vendimi hynë në fuqi me datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit të Komunes
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës;
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorisë për Shërbime Publike;
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër e Pronë;
- Arkivit.



Kryetari i Komunës

Arman Gjini



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna: Gjakovë Zona Kadastrale: Gjakovë -Qytet					
Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese					
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji I shfrytezimit të parceles/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për servityt m ² (Lx1m)
1	ALIRIZA(XHEVDET)PRUTHI	802-0	Shtëpi,oborr dhe pemishte	945	35
2	1/3GJEJLONE(MUSTAFA)HOXHA 2/3 MEHDI(SEFEDIN)HOXHA	795-0	Shtëpi,oborr dhe are	1175	42
3	1/3GJEJLONE(MUSTAFA)HOXHA 2/3 VALON(MEHDI)HOXHA	649-0	Shtëpi dhe oborr	354	9
4	ZIJA (ALUSH) HAXHIKADRIJA	648-2	Shtëpi dhe oborr	428	20
Totali				2902	106